# DËSHMI ARKIVI

**A-447172**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Nga interpelancat me 5 ministra, tek votimi i draftit për pagat e magjistratëve! Çfarë pritet në seancën e së enjtes në Kuvend, zbardhet rendi |
| ADRESA | `https://prapaskena.com/2026/09/15/nga-interpelancat-me-5-ministra-tek-votimi-i-draftit-per-pagat-e-magjistrateve-cfare-pritet-ne-seancen-e-se-enjtes-ne-kuvend-zbardhet-rendi/` |
| BURIMI | prapaskena.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 19:21:19 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 19:18:22 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `810b36e9b01efc494f6bc6cf253dfb9c799120a138cf7d71c65eee3b043f437a` |
| TEKSTI | `cd23bc37da2d98dbaa4d0abc7ca7ab271eb988dd25da61cad25144e132fa960b` |
| PAMJA | `24a372719a3a856331e5c6d329d9bddb825e89a8bf9219659b414f542d2e4f6a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d3cdc8f3911d43cd5c4c5b831b666a0869684c548c15ec177bbb8765cf82df1f` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d3cdc8f3911d43cd5c4c5b831b666a0869684c548c15ec177bbb8765cf82df1f`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Nga interpelancat me 5 ministra, tek votimi i draftit për pagat e magjistratëve! Çfarë pritet në seancën e së enjtes në Kuvend, zbardhet rendi

Politikë

Publikuar: 15/09/2026




Kuvendi do të mblidhet ditën e enjte në seancë plenare (17 shtator), ku do të diskutohen një sërë çështjesh me rëndësi, mes të cilave do të ketë edhe disa interpelanca me ministrat.

Sipas rendit të ditës të njoftuar nga Kuvendi, deputetët do të zhvillojnë katër interpelanca urgjente me ministrat e Mjedisit, Punëve të Brendshme, Arsimit dhe Shëndetësisë, të kërkuara nga një grup deputetësh të Partisë Demokratike.

Në seancë do të realizohet edhe një interpelancë me Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, Enea Karakaçi, e kërkuar nga deputeti Blendi Himçi.

Në vijim, Kuvendi do të votojë disa projektligje, mes tyre ratifikimin e Konventës për Themelimin e Komisionit Ndërkombëtar të Kërkesave për Ukrainën dhe Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës për Inteligjencën Artificiale, të Drejtat e Njeriut, Demokracinë dhe Shtetin e së Drejtës.

Në rendin e ditës janë përfshirë gjithashtu ndryshime në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, projektligji për dizenjot dhe ndryshime në ligjin për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike.

Komisioni i Ligjeve, si komision përgjegjës, miratoi në 15 shtator projektligjin e Partisë Socialiste për pagat e magjistratëve. Nisma mori 8 vota pro të mazhorancës dhe 3 vota kundër të opozitës.

Pas miratimit në Komisionin e Ligjeve, projektligji pritet të kalojë për votim në seancën plenare të 17 shtatorit. Drafti i PS

Me te lexuarat


Lufta e egër e Berishës ndaj Azem Hajdarit nga përgjimi, shantazhi, përjashtimi nga PD tek ndeshk...


Kushtetuesja tha se arresti ishte jo proporcional, Gjykata e Lartë lë në burg kryebashkiakun...


Greqia i kërkon Parlamentit Europian heqjen e imunitetit të deputetit socialist të PASOK-ut, Niko...


Avokati i Erion Veliajt: Pse nesër presim lirimin e tij nga burgu


Detaje/ Kokaina e kapur në Portin e Durrësit ishte fshehur në kontejnerët e 'diMAL'!

parashikon një rritje me rreth 8500 lekë për rrogën referuese të magjistratëve, ndërkohë që pretendimi i tyre, i miratuar edhe nga KLGJ e KLP, është 9-fish më i lartë, rreth 80 mijë lekë më e lartë.

Seanca do të mbyllet me diskutime për çështje jashtë rendit të ditës, për të cilat deputetët do të kenë në dispozicion deri në 60 minuta.

## SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 17 shtator 2026, ora 10:00

## RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrit nr. 54, datë 15.9.2026 të Kryetarit të Kuvendit, z. Niko Peleshi, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 8.9.2026.
   *(Neni 44, pika 2, të Rregullores së Kuvendit)*

2. Njoftime.
   *(Neni 44, pika 3, të Rregullores së Kuvendit)*

3. **Interpelancë urgjente me Ministrin e Mjedisit, z. Sofjan Jaupaj, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit)*

4. **Interpelancë urgjente me Ministrin e Punëve të Brendshme, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit)*

5. **Interpelancë urgjente me Ministren e Arsimit, znj. Mirela Kumbaro, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit)*

6. **Interpelancë urgjente me Ministren e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, znj. Klodiana Spahiu, kërkuar nga një grup deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.** *(Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës dhe nenit 97 të Rregullores së Kuvendit)*

TAG: Edi rama

## Të ngjashme



**Rama drejt SHBA për Asamblenë e OKB, takim edhe me shqiptarët**



**"Vendimi i KLGJ dhe KLP, i turpshëm"/ Pagat e magjistratëve, Spaho: Vendosin Qeveria dhe Kuvendi!**



**"Askush nuk na urdhëron dot" – Rama vazhdon replikat me gjyqtarët: Janë bërë si ultrasit që bërtasin rrugëve**

## Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësuara me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

## Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

## Kategoritë



Email: [email protected]

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena
Privacy Policy | Cookies

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.